



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VE N D I M

Nr. 111, datë 28.09.2020

“PËR

PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESES PRIVATE (PALLATI NR. 159 (RRUGA “LLAZI MIHO”), NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 6, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, “Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 34, nenit 35, të Aktit Normativ me nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 45/2019, “për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendim nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësia administrative 6, zona kombinat, bashkia tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese” (si edhe në vijim të shkresës me nr. 1690/2 prot., datë 20.07.2020, të Institutit të Ndërtimit protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 23589/1 prot., datë 20.07.2020), memos nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile nr. 30966 prot., datë 17.09.2020, me objekt “Mbi njohjen me aktekspertizat e thelluara të kryera nga Operatorët Ekonomikë të kontraktuara nga Bashkia Tiranë, Oponencat Teknike të kryera nga Instituti i Ndërtimit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës private, pallati nr. 159, rruga “Llazi Miho”, në Njësinë Administrative nr. 6, Tiranë, mbështetur në akt ekspertizën e thelluar dhe konkluzionin e oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.
5. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit sipas këtij vendimi, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.
6. Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit kërkon asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

7. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, si dhe afishohet në stendat publike pranë njësisë administrative nr. 6.

8. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Njësisë Administrative nr. 6, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU